REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**
**ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE**

Nr. 556 Regj Lushnje, më 08.09.2021

VENDIM SHPALLJE

*(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)*

Unë Endrin Kashari, me detyrë Kryetar i Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet proçeduriale të çështjes përmbarimore nr. 556, datë 25.08.2021, bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.1199 (804), datë 19.11.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë,

KONSTATOVA:

Se në datë 20.08.2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit nr. 1199(804), datë 19.11.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, me palë:

- Kreditor: Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë
- Debitor: Baftiar Ali Miftaraj
- Objekti: Gjobë Administrative

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar proçedura në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *" Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbrimor Gjyqësor"*, i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Baftiar Ali Miftaraj nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj, bazuar në nenet 133/a, 133/b, 144/a dhe nenit 517 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kredirore Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. 1199 (804), datë 19.11.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Shkallës së Parë Korçë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, 144/a dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, daë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbrimor Gjyqësor* ", i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 09.09.2021 – 28.09.2021 të debitorit Baftiar Ali Miftaraj;
2. Ky vendim përpilohet në pesë kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në këndin e publikimeve të Bashkisë Divjakë, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Baftiar Ali Miftaraj me banim në Ferras, Nj. Ad. Grabjan, Bashkia Divjakë;
4. Pala debitore Baftiar Ali Miftaraj me banim në Ferras, Nj. Ad. Grabjan, Bashkia Divjakë të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen "Çlirimi", kati i parë, hyrja tek sekretaria e Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe të marr kontatkte me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t'iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim e detyrueshëm sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

*U shpall në Lushnje, sot më datë 08.09.2021*

KRYETARI I ZYRËS
Endrin Kashari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E DREJTËSISË - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT - ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE